



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 2, datë 08.03.2023

PËR
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA
MIRDITË, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.2, DATË 20.06.2018,
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr.2, datë 20.06.2018 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Mirditë”, i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, si dhe referuar Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr. 11, datë 31.01.2023, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Mirditë, të miratuar me Vendimin Nr.2, datë 20.06.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit, i ndryshuar, të bëhen ndryshime në dokumentin e:
 - *Rregullores së Planit:*
 - Në pikën 3.4 “Dispozita të Përgjithshme”, nënpika 1 riformulohet;
 - Në pikën 3.4 “Dispozita të Përgjithshme”, nënpika 4 riformulohet;
 - Pas pikës 3.5 “Të drejtat dhe kufizimet ligjore, publike apo private që rrjedhin nga përdorimi i treguesve të zhvillimit”, shtohet pika 3.5/1 “Madhësia minimale e parcelës”;
 - Pika 3.6 “Rregullat për zhvillimet në sistemet Urban, Bujqësor dhe Natyror”, riformulohet;
 - Pas pikës 5.4 “Përcaktimi i vijës së ndërtimit (Vija e kuqe)”, shtohet pika 5.4/1 “Kufizimi i ndërtimeve përgjatë rrugëve të kategorive A, B dhe C”;
 - Në pikën 5.5 “Përcaktime për infrastrukturën inxhinierike”, pas nënpikës “Sistemi i furnizimit me ujë” shtohet nënpika “Burimet e ujrave”;

- Në pikën 5.5 “Përcaktime për infrastrukturat inxhinierike”, nënpika “Sistemi i ujitjes dhe kullimit”, pas paragrafit të dytë shtohen paragrafët 3 dhe 4;
- Pas pikës 6.1 “Normat, standartet dhe rregullat për zhvillimet, që kanë ndikim në mjedis, shëndet, peizazh dhe në trashëgiminë kulturore, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi”, shtohet pika 6.1/1 “Varrezat;
- Pika 6.2 “Përcaktimi i zonave mbrojtëse përgjatë baseneve ujore (Vija Blu)”, riformulohet;

- Tabelat e treguesve të zhvillimit të njësive strukturore;

sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Mirditë, bashkëlidhur këtij Vendimi.

2. Ngarkohen Bashkia Mirditë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.
3. Ngarkohen Bashkia Mirditë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA HOTA

